

V E N D I M
PER RREGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Sot me date 10.7.1996, ne Gjykatën e Rrethit Tirane, une gjyqtarja e kesaj gjykate pasi u njoha me materialet e paraqitura nga:

1. Ilir Kumbaro
2. Vladimir Pashaj

te cilet paraqiten kerkesen e tyre per te bere regjistrimin e shoqerise "I.V.A. ELEKTRONIK" ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar
Pasi shqyrtova kerkesen e tyre :

K O S T A N T O V A

Kerkuesit kerkojne qe te bejne regjistrimin e shoqerise "I.V.A. ELEKTRONIK" sh.p.k. me ortake zoterinjte Ilir Kumbaro dhe Vladimir Pashaj .
Qendra e kesaj shoqerie do te jete ne qytetin e Tiranës rruga Myslym Shyri , kulla 2 , ap 17.

Kapitali themeltar eshte ne vleften 100 000 leke. Kapitali eshte i ndare ne kuota 1000 leke seicila, gjithesej ne 100 kuota , te cilat midis ortakeve ndahen:

1. Ilir Kumbaro 51% , nga 1-52;
2. Vladimir Pashaj 49% , nga 52-100;

Kohezgjatja e e veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte mbi 10 vjete.
Administratori i saj do te jete Ilir Kumbaro.

Objekti i veprimtarise i kesaj Shoqerie do te jete:

-projektimi dhe prodhimi i paisjeve e makinerive ne fushen e automatikes , elektronikës , industrise dhe informatikes , si dhe shkollimi i personave ne keto fusha; instalime dhe mirembajtje te impianteve dhe sistemeve televizive, telefonike, radionderlidhje , telekomunikacionit , te sigurimit te objekteve; importi dhe eksporti i te gjitha llojeve te produkteve , lendeve te para dhe paisje e makineri; tregetimi me shumice dhe pakice; sfera e sherbimeve.

Pasi shqyrtova kerkesen e tyre konstatova se ajo eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 64 te Ligjit nr 7667 daet 28.1.1993 dhe Ligjit nr 7638 date 19.11.92 "Per shoqerite tregtare"

V E N D O S A

Regjistrimin e shoqerise "I.V.A. ELEKTRONIK" si person juridik duke mare formen e nje Shoqerie me Pergjegjsi te Kufizuar , me seli ne qytetin e Tiranes rruga Myslym Shyri , kulla 2 ,ap 17., me kohezgjatje te veprimtarise ekonomike mbi 10 vjet,me administrator z.Illir Kumbaro dhe objekt te veprimtarise *projektimi dhe prodhimi i paisjeve e makinerive ne fushen e automatikes , elektronikes , industrise dhe informatikes , si dhe shkollimi i personave ne keto fusha, instalime dhe mirembajtje te impianteve dhe sistemeve televizive, telefonike, radionderlidhje , telekomunikacionit , te sigurimit te objekteve,importi dhe eksporti i te gjitha llojeve te produkteve , lendeve te para dhe paisje e makineri,tregetimi me shumice dhe pakice,sfera e sherbimeve.*

Veprimtaria e shoqerise drejtohet nga asambleja e ortakeve dhe administrator i saj eshte z. Ilir Kumbaro.

Kunder ketij vendimi lejohet Ankimi ne Gjykatën e Apelit.

Tirane me 10.7. 1996

GJYQTARE



Ilir Kumbaro
[Signature]

Master Repman

5388

Me. acc. 1

a. In. Sup. Mop. "IVA Elektronik"
S. B. K.

b. In. R. Flypa. Kello 2 of 12
9 Projekti Proden. 700000
Suomen. Su. f. 10.000.000.000
oby. Seppos. Helsinki

c. 100000 l. certificate.
At 4.7.1986. B.K.T.H.
Department

3. In. Mr. J. M. B. M. 1953
Lundin no. 1100

Institute of Research and 4.7.1986
State no 5/86

Date 10.7.1986



A K T - T H E M E L I M I
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUR



I.V.A. ELEKTRONIK Sh.P.K

Personat qe firmosin me poshte,

Z. Ilir Kumbaro, lindur me 3.03.1953 ne Tirane, banues ne Tirane , Rr Myslym Shyri , Kulla 2 , Ap17.

Z. Vladimir Pashaj, lindur me 8 .09.1949 ne Vlore , banues ne Tirane , Rr Bajram Curri, Pall 400/3, Sh 1 Ap 9

kane hartuar si me poshte vijon , aktin e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar .

Shoqeria funksionon ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi si dhe dispozitave te statutit qe i bashkengjitet ketij akti.

Emertimi i shoqerise eshte I.V.A. Elektronik Sh.P.K.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

-projektimi dhe prodhimi i paisjeve e makinerive ne fushen e automatikes , elektronikes , industrise dhe informatikes , si dhe shkollimi i personave ne keto fusha.

- instalime dhe mirembajtje te impianteve dhe sistemeve televizive,telefonike, radionderlidhje , telekomunikacionit , te sigurimit te objekteve.

-importi dhe eksporti i te gjitha llojeve te produkteve , lendeve te para dhe paisje e makineri.

-tregetimi me shumice dhe pakice.

-sfera e sherbimeve

Shoqeria mund te ushtroje gjithashtu aktivite te tjera ndihmese, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe te konsideruara nga shoqeria me perfitim dhe te dobishme per arritjen e objektivave te saj kryesore.

Seline e saj shoqeria do ta kete ne Rruga Myslym Shyri , Kulla 2 Apt 17, Tirane.

Kapitali themeltar eshte ne vleften 100 000 leke. Kapitali eshte i ndare ne kuota 1000 leke seicila, gjithesej ne 100 kuota , te cilat midis ortakeve ndahen:

1. Ilir Kumbaro 51% , nga 1-51;

2. Vladimir Pashaj 49% , nga 52- 100;

Kapitali i mesiperm mund te shtohet ose te pakesohet ne funksion te veprimtarise se shoqerise.

Kapitali i shoqerise eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem nga ortaket themelues.

Veprimtaria e shoqerise do te udhehiqet nga vendimet e asamblese se ortakeve.

Shoqeria do te drejtohet nga nje administrator i vetem. Administrator i pare eshte emeruar z. Ilir Kumbaro. Administratorit i jepen te gjitha kopetencat te cilat ai i pranon, per te kryer te gjitha formalitetet e themelimit te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi. Ai eshte i autorizuar te veproje ne emer te shoqerise nga casti i regjistrimit te saj ne regjistrin tregetar. Ne vecanti ai eshte i paisur me mandat qe te perpiloje akte dhe te mare persiper detyrime ne emer te shoqerise , nga casti i regjistrimit te

saj. Administratori është i ngarkuar të kryejë veprime dhe të marrë angazhime të cilat janë në përputhje me objektin e shoqërisë dhe kompetencat e tij. Mbas të bëhet regjistrimi i shoqërisë, këto akte dhe angazhime do të nështrohen shqyrtimit nga ortaket dhe do të sistemohen mbi llogaritë e vitit të parë financiar. Ky miratim bëhet automatikisht kalimin e këtyre akteve dhe angazhimeve në ngarkim të shoqërisë.

Kohe zgjatja e shoqërisë është 10 vjet. Ajo mund të zgjatet me miratimin e ortakeve. Ortaket kanë të drejtë të terhiqen prej shoqërisë duke vënë në dijeni një vit më parë.

Largimi bëhet me shkrim.


Viti i parë financiar mbyllet më 31 Dhjetor të vitit 1996.

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakeve, të cilat nuk zgjidhen me mirkuptim, i paraqiten për shqyrtim dhe zgjidhje Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

Ky akt themelimi përpilohet në disa kopje për tju shpërndarë organeve kompetente, ndërsa një kopje mbetet si pjesë e perberësë së dokumentacionit të shoqërisë L.V.A. ELEKTRONIK.

ORTAKET THEMELUES

Ilir Kumbaro



Tiranë, më 15.06.96

Vladimir Pashaj



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
Tiranë

Nr. 9584 Rep
Nr. 1086 Kol

VERTETIM

Sot më datë 17.06.96, para meje noterit së zyres së noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht ortaket:

Z. Ilir Kumbaro, lindur më 3.3.1953 Tiranë, banues në Tiranë, Rr Myslym Shyri, Kulla 2, Ap 17.

Z. Vladimir Pashaj, lindur më 8.09.1949 në Vlorë, banues në Tiranë, Rr Bajram Curri, Pall 400/3, Sh 1 Ap 9

për identitetin e të cileve u sigurova nga letërnjoftimet që ata mbajnë, të cilat janë mëdha dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, janë dakord të nënshkruajnë rregullisht për sa më sipër dhe unë noterit e vertetova sipas ligjes.

NOTERI





STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJSI TE KUFIZUAR

I.V.A. ELEKTRONIK SH.P.K

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar I.V.A. ELEKTRONIK u krijua ne baze te aktit te themelimit qe i bashklidhet ketij statuti, ditën qe u perpilua dhe u nenshkrua nga ortaket:

Z. Ilir Kumbaro, lindur me 3.03.1953 ne Tirane, banues ne Tirane , Rr Myslym Shyri , Kulla 2 , Ap17.

Z. Vladimir Pashaj, lindur me 8 .09.1949 ne Vlore , banues ne Tirane , Rr Bajram Curri, Pall 400/3, Sh 1 Ap 9

Ortaket jane mare vesh te krijojne shoqerine dhe kane hartuar si me poshte vijon , Statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar.

1.FORMA.

Shoqeria krijohet dhe zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me te gjitha dispozitat e ketij Statuti , si dhe te legjislacionit te Republikes se Shqiperise.

2. EMERTIMI SHOQERISE.

Emertimi i shoqerise eshte **I.V.A. ELEKTRONIK Sh.P.K.**

3.OBJEKTI

Objektii veprimtarise se Shoqerise do te jete:

-projektimi dhe prodhimi i paisjeve e makinerive ne fushen e automatikes , elektronikës , industrise dhe informatikes , si dhe shkollimi i personave ne keto fusha.

- instalime dhe mirembajtje te impianteve dhe sistemeve televizive,telefonike, radionderlidhje , telekomunikacionit , te sigurimit te objekteve.

-importi dhe eksporti i te gjitha llojeve te produkteve , lendeve te para dhe paisje e makineri.

-tregetimi me shumice dhe pakice.

-sfera e sherbimeve

Shoqeria mund te ushtoje gjithashtu aktivitete te tjera ndihmese, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe te konsideruara nga shoqeria me perfitim dhe te dobishme per arritjen e objektiveve te saj kryesore.

4. SELIA E SHOQERISE.

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne Tirane , por mund ta zgjeroje dhe ne rrethe te tjera te Shqiperise si dhe jashte vendit. Seline e saj shoqeria do ta kete ne Rruga Myslym Shyri , Kulla 2 Apt 17, Tirane.

Shoqeria mund ta ndryshoje seline me miratimin e ortakeve.

5.KOHEZGJATJA.

Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe prej 10 vjetesh nga data e regjistrimit te saj ne gjykate.

Kjo periudhe mund te zgjatet tej ketij afati ose te shkurtohet ne varesi te veprimtarise se shoqerise.

6.KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE.

6.1 Kapitali themeltar perbehet nga kontributi i ortakeve ne vleften 100 000leke Kapitali eshte i ndare ne kuota 1000 leke seicila, gjithesej ne 100 kuota , te cilat midis ortakeve ndahen:

- 1.Illir Kumbaro 51% , nga 1-51;
- 2.Vladimir Pashaj 49% , nga 52-100;

Ne rast shtese te kapitalit themeltar, nepermjet shtimit te pjeseve te reja, ortaket kane te drejten e perparise ne neshkrimin proporcionalisht me shumen e pjeseve te tyre.Cdo ortak nuk kufizohet ne drejtim te ritjes se pjesemarjes ne kapitalin themeltar. Shoqeria mund te zvogloje kapitalin e saj.Zvogelimi i kapitalit vendoset nga ortaket me mirekuptim, ne rast te kundert me aprovimin e ortakeve qe kane me shume se $\frac{3}{4}$ te kapitalit themelor.

Pakesimi i kapitalit ndikon tek te gjithë ortaket ne te njejtën mase.

Kapitali i shoqerise eshte teresisht i shlyeshem dhe i neneshkrueshem nga ortaket themelues.

6.2 Kapitali themeltar eshte depozituar ne Banken e Kursimeve , Dega Tirane.

6.3 Kapitali themeltar mund te shtohet ose te zvoglohet ne varesi te rezultateve dhe nevojave ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

6.4 Kapitali themeltar mund te transferohet jashte shoqerise

6.5 Pjese te kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, ne rruge trashgimnie, ne rast ndarje te pasurise ndermjet bashshorteve, ndermjet te paralindurve dhe te paslindurve.Kur nje nga ortaket do te shese pjese te kapitalit te tij me perpara duhet qe pjesen e kapitalit te tij tua ofroje ortakeve te tij dhe ne rast se ortaket nuk pranojne ti blejne atehere ortaku ka te drejte qe pjesen e vet te kapitalit tua shese te treteve, por jo me cmim me te ulet se cmimi i propozuar ortakeve.

6.6 Fitimet e shoqerise ju perkasin ortakeve themelues ne raport me pjesen e depozituar nga secili ne kapitalin themelor.

7. ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

7.1 Si organ i vetem drejtues i shoqerise , i cili eshte perbere nga te dy ortaket, eshte *asambleja e ortakeve*.

7.2 E gjithë veprimtaria e shoqerise percaktohet nga asambleja e ortakeve ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.Cdo ortak ka te drejte vote te barabarte me pjesen e tij ne kapitalin themelor qe ai zoteron. Ne ushrimin e te drejtes se tyre per te mare pjese ne vendimet kolektive , cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga bashkshorti ose nje person tjeter i zgjedhur prej tij si dhe me avokat.

7.2.1 Asambleja e ortakeve mund te thiret nga secili ortak, nga administratori, eksperti kontabel i autorizuar apo nga likuiduesi.Sipas rendesise se vendimeve , asambleja e ortakeve mund te jete e zakonshme ose e jashtzakonshme.Asambleja e zakonshme e ortakeve vendos per ceshtje te tilla si emerimi apo shkarkimi i administratorit, ekspertit kontabel te autorizuar dhe likuidatorit , miratimi i raporteve te administrimit dhe te kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarja e fitimit etj.

Asambleja e jashzakonshme vendos per ceshtje te tilla si ndryshimi i statutit, pakesimi i kapitalit themelor, transferimi i pjeseve te kapitalit themelor tek te trete, zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqerise ose likuidimi i saj, ndryshimi i shoqerise ne forma te tjera etj.

7.3 Per administrimin e shoqerise ose te aktiviteteve te veacnta te saj asambleja ortakeve, me shumice votash ,emeron administratorin e shoqerise, i cili duhet te jete nje person fizik dhe mund te jete ose jo ortak. Emerimi i tij behet per nje periudhe 3-vjecare , me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem.

7.3.1 Ne maredheniet me ortaket dhe te tretet , administratori ka te gjitha kopetencat per te kryer te gjitha veprimet administrative ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise, me perjashtim te atyre kopetencave qe ligji dhe ky statut ju japin shprehimisht ortakeve.

Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj ortakeve qofte per shkelje te statutit qofte per faje te kryera gjate administrimit te tij. Ai ka te drejte te delegoje nje pjese te kopetencave te tij nje tjetri me ane te nje akti me shkrim.

Shoqeria nuk merr persiper veprime te ndryshme te mundshme te administratorit ne maredhenie me te tretet , te cilat i tejkalojne kopetencat e tij te percaktara ne statut.

Administratori i shoqerise eshte Ilir Kumbaro, i cili perfaqeson juridikisht shoqerine ne te gjitha veprimtarite juridike , civile dhe ekonomike.

Shkarkimi i administratorit vendoset ne te njejtat kushte si emerimi.

7.5 Asambleja e ortakeve, emerone nje ose disa eksperte kontabel per nje periudhe te caktuar. Emerimi apo shkarkimi i eksperteve kontabel behet me shumice votash.

7.6 Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saj , deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin fillestar.

8. KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

8.1 Vendos per ndryshimet ne statut dhe miraton rregulloret e shoqerise ose te sektoreve te vecante te saj.

8.2 Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.

8.3 Zgjedh dhe shkarkon administratorin e shoqerise dhe percakton kopetencat e tij.

8.4 Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor , kuotat e fondeve te ndryshme si dhe fitimin e realizuar.

8.5 Vendos per krijimin e degeve ose perfaqesive brenda dhe jashte vendit.

8.6 Vendos per marrjen e kredive ose per mbarimin e shoqerise.

8.7 Vendos per shndrimin e shoqerise nga Sh.P.K. ne shoqeri te tipeve te tjera.

8.8 Miraton ose realizon maredheniet me te rendesishme te shoqerise me persona te tjere juridike ose fizike.

8.9 Miraton cmimet e blerjes, shitjes ose te sherbimeve.

8.10 Vendos per pagat e personelit te punesuar ne shoqeri.

9. KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT.

9.1 Administratori do te jete nje person fizik dhe mund te zgjidhet ose jo ndermjet ortakeve.

9.2 Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratimin e ortakeve qe kane me shume se 1/2 te kapitalit themelor.

9.3 Ne marrëdhëniet me ortakët dhe të tretët , administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e shoqërisë , me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe statuti ja japin shprehimisht ortakëve.

9.4 Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të treteve , qoftë për shkeljet ligjore , qoftë për shkelje të statutit ose për fajta të kryera gjatë administrimit të tij.

10. NDARJA E FITIMIT.

10.1 Pas përballimit të detyrimeve , taksave , tatimeve, shpenzimeve të ndryshme , ortakëve iu mbetet në dispozicion fitimi neto.

10.2 Fitimi neto mund të përdoret për zgjerimin e kapitalit themelues, për shtimin e tij me kapital në natyrë ose të ndahet midis ortakëve.

10.3 Ndarja e fitimit do të bëhet në proporcion me pjesën e kapitalit të secilit ortak.

11. MARRËDHËNJET E PUNESIMIT

11.1 Çdo person i punësuar në shoqëri konsiderohet si i tillë mbi bazën e kontratës së punës të lidhur ndërmjet tij dhe shoqërisë në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi.

11.2 Çdo person i punësuar në shoqëri është personalisht përgjegjës për kryerjen e detyrës. Ai është i detyruar të ruajë karakterin e fshehtë të dokumentacionit , të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës si dhe nga vendimet e mara nga shoqëria

12. MBARIMI I SHOQËRISË.

12.1 Veprimtaria e shoqërisë mbaron me vendim të asamblesë së ortakëve, në rast se aktiviteti i saj nuk rezulton fitimprurës, për shkak të forcave mëdha si dhe për shkaqe të tjera ligjore.

12.2 Shoqëria mund të mbarojë dhe me anë të riorganizimit nëpërmjet formave të thithjes dhe të bashkimit.

12.3 Me mbarimin e afatit që përcaktohet në nenin 5 të këtij statuti , zgjatja e tij mund të vendoset nga asambleja , me miratimin e ortakëve që kanë më shumë se $\frac{3}{4}$ të vlerës së kapitalit themelues.

12.4 Shoqëria nuk mbaron kur njëri nga ortakët falimenton , bëhet i paafte ose vdes.

13. LIKUIDIMI.

13.1 Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që nga momenti i shpërndarjes së saj.

13.2 Asambleja e ortakëve cakton një ose disa likuidues, të cilët paraqesin në një raport gjendjen e aktivitetit ose pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e përfundimit të tij.

Në fund të procesit të likuidimit , asambleja e ortakëve vendos , me aprovimin e ortakëve që kanë më shumë se $\frac{1}{2}$ të vlerës së kapitalit themelues, mbi bilancin përfundimtar, mbi aktin e rregullshmerisë së punës së likuiduesit dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit.

Mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themelues tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetur midis ortakëve , proporcionalisht me pjesët që ata zoterojnë në kapitalin themelues.



14.DISPOZITA TE FUNDIT.

14.1 Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor

14.2 Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Shqiperise.

14.3 Shoqeria do te kete vulen e saj , forma dhe madhesia e te ciles percaktohet nga asambleja e ortakeve.

14.4 Te gjitha mosmarveshjet midis ortakeve qe nuk zgjidhen me mirekuptim i paraqiten per shqyrtim dhe zgjidhje Gjykates se Rrethit Tirane.

14.5 Ky statut perpilohet ne disa kopje per tu shperndare organeve kopetente , ndersa nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te shoqerise I.V.A. ELEKTRONIK sh.p.k.

ORTAKET

Ilir Kumbaro

Tirane me 15.06.96

Vladimir Pashaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
Tirane

Nr 3839 Rep
Nr 1096 Kol

VERTETIM

Sot me date 9.7.96, para meje noterit se zyres se noterise Tirane, u paraqiten personalisht ortaket:

Z. Ilir Kumbaro , lindur me 3.3.1953 Tirane, banues ne Tirane, Rr Myslym Shyri, Kulla 2, Ap 17.

Z. Vladimir Pashaj, lindur me 8 .09.1949 ne Vlore , banues ne Tirane , Rr Bajram Curri, Pall 400/3, Sh 1 Ap 9

per indentitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimet qe ata mbajne ,madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar ,te cilet deklaruan se ky akt eshte redaktuar me vullnetin e tyre , jane dakord te nenshkruajne rregullisht per sa me siper dhe une noterit e vertetova sipas ligjes.

NOTERI





K E R K E S E
PER RGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK



Tirane, 16,06,96

Kerkuesit: Ilir Kumbaro,
Lindur me 3.03.1953 ne Tirane, banues ne Tirane , Rr Myslym Shyri ,
Kulla 2 , Ap17.
Me shtetesi shqiptare
Me zotesi te plote juridike per te vepruar

Z. Vladimir Pashaj,
lindur me 8 .09.1949 ne Vlore, banues ne Tirane, Rr Bajram Curri,
Pall 400/3, Sh 1 Ap 9
Me shtetesi shqiptare
Me zotesi te plote juridike per te vepruar

Objekti: Te behet regjistrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "IVA
ELEKTRONIK" SH.P.K. Ligji Nr 7638 date 19.11.1992 dhe ligji Nr
7667 date 28.1.93

GJKATES SE RRETHIT

TIRANE

Ne baze te aktit te themelimit dhe te statutit , date 15.06.96 , bashklidhur kesaj kerkese , shoqeria qe kemi themeluar ka si objekt te veprimtarise se saj : *projektimi dhe prodhimi i paisjeve e makinerive ne fushen e automatikes , elektronikes , industrise dhe informatikes , si dhe shkollimi i personave ne keto fusha, instalime dhe mirembajtje te impianteve dhe sistemeve televizive, telefonike, radionderlidhje , telekomunikacionit , te sigurimit te objekteve,importi dhe eksporti i te gjitha llojeve te produkteve , lendeve te para dhe paisje e makineri,tregetimi me shumice dhe pakice,sfera e sherbimeve.*

Duke menduar se i plotesojme kushtet e percaktuara nga ligji per shoqerite tregtare si dhe ai per regjistrin tregtar , lutemi te vendoset pranimi i kesaj kerkese per te bere regjistrimin e shoqerise "IVA ELEKTRONIK" SH.P.K.

KERKUESIT

Ilir Kumbaro

Vladimir Pashaj

Handwritten notes and signatures at the bottom of the page, including the name 'Ile. Pashaj' and the date '28.07.1996'.